



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATËVE NGA LISTAT SHUMEMËRORE PËR KËSHILLAT BASHKIAK TË PARTISË ALEANCA DEMOKRISTIANE NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 19.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

**OBJEKT:** Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listave shumëmemërore për këshillat bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet për qeverisjen vendore të datës 30 qershor 2019.

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; neni 5, pika 4, germa "a" i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,



**Nr . 575 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit**

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak , të Partisë Aleanca Demokristiane në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

## VËREN

Partia Aleanca Demokristiane, në përputhje me nenin 5, pika 4, germa "a" të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, të kandidatëve për këshillin e bashkisë, Pukë, Libohovë, Krujë, Këlcyrë, Kurbin, Malësi e Madhe, Mat, Prrenjas, Mirditë, Klos, Përmet, Gjirokastër, Tropojë, Dibër, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", KQZ verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat të listës shumëmemërore.

Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, të kandidatëve për anëtarë në këshillat bashkiak, për këto bashki : Pukë, Libohovë, Krujë, Këlcyrë, Kurbin, Malësi e Madhe, Mat, Prrenjas, Mirditë, Klos, Përmet, Gjirokastër, Tropojë, Dibër asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

- a. Zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, për bashkitë Pukë, Libohovë, Krujë, Këlcyrë, Kurbin, Malësi e Madhe, Mat, Prrenjas, Mirditë, Klos, Përmet, Gjirokastër, Tropojë, Dibër sipas së cilës rezultojnë sipas së cilës rezultojnë të padënuar nga gjykatat shqiptare, përçes shtetasve të mëposhtëm:

**Bashkia Mat, Nr.5 rendor, z.Elton Cakoni** në bazë të vendimit nr.43 Dt.22.06.07 të Gjykatës së Rrethit Mat është deklaruar fajtor për veprën penale të Mbajtjes pa Leje të Armëve Luftarake dhe në bazë të nenit 278/2 K.P. dënimin e tij me 9 (nëntë) muaj burgim. Deklarimin fajtor për prishje të qetësisë publike dhe në bazë të nenit 274 K.PR. penale dënohet me 3 muaj burgim. Në aplikim të nenit 55 K.P. dhe nenit 406 të K.PR. penale dënohet me 6 (gjashtë) muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të K.P. urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për 18 muaj kohë me kusht. (Rehabilituar në bazë të nenit 69 të K.Penal)

**Bashkia Krujë, nr. 17 rendor, z.Mondi Bami** në bazë të vendimit nr.25 Dt. 17.02.2010 të Gjykatës së rrethit gjyqësor Krujë është deklaruar fajtor për veprën penale të drejtimit të mjetit ëpa dëshmi dhe në bazë të nenit 291 të K.P. dhe nenit 406 të K.PR. dënohet me 60.000 mijë lekë gjobë.(Rehabilituar në bazë të nenit 69 të K.Penal).



### **Nr . 575 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit**

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak , të Partisë Aleanca Demokristiane në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

**Bashkia Krujë, Nr. 17 z.Agim Haka** në bazë të vendimit nr.5 Dt. 16.01.1982 të Gjykatës së rrethit gjyqësor Krujë është deklaruar fajtor për veprën penale të vrasjes së mbetur në tentativë dhe në bazë të nenit 84/A, 11/2 K.Penal e dënon me 7 (shtatë) vjet heqje lirie. (Rehabilituar në bazë të nenit 69 të K.Penal)

**Bashkia Krujë, Nr. 19 z.Sali Caca** në bazë të vendimit nr.43 Dt. 27.02.2015 të Gjykatës së rrethit gjyqësor Krujë është deklaruar fajtor për veprën penale të shkeljes së të drejtave të pronësisë industriale . Në bazë të nenit 149/a/1 të K.P dhe 406 të K.PR.P dënohet me 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 63 të K.P dënimi me burgim zëvendësohet me 120 orë punë në interes publik. (Rehabilituar në bazë të nenit 69 të K.Penal).

**Bashkia Malësi e Madhe, Nr. 14 z.Fatos Hasa** në bazë të vendimit Nr.131 date 04/05/2006, gjykata e rrethit gjyqësor Shkodër ka deklaruar fajtor për veprën penale të ndërprerjes së shtatëzanisë pa pëlqimin e gruas në bashkëpunim parashikuar nga neni 93,25 K.P dhe dënohet me 200000 lekë gjobë. Gjykata e apelit Shkodër me vendim Nr 252 datë 02/11/2006 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit. Rehabilituar në bazë të nenit 69 të K.Penal.

**Bashkia Tropojë, Nr. 4 z.Gjon Neçaj** me vendim Nr 13 Dt 01/04/2014 gjykata e rrethit gjyqësor Tropojë deklaron fajtor për vepren penale "Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt " parashikuar nga neni 291 të K.Penal dhe neni 406 të K.Penal dënohet me 3 muaj burgim .Në aplikim të nenit 63 të K.Penal vihet të kryej një punë me interes public për 80 orë punë. Rehabilituar në bazë të nenit 69 të K.PENAL.

**Bashkia Malësi e Madhe, Nr. 8 z.Mirash Fusha** në bazë të vendimit nr 7 Datë 01.02.1999 të gjykatës së rrethit gjyqësor Shkodër është deklaruar fajtor për veprat penale të armëmbajtje pa leje parashikuar nga neni 278/2 K.P e dënohet me 2 muaj burg. Deklarohet fajtor per heqje të paligjshme të lirisë në lirisë në bashkëpunim e në bazë të nenit 110/1 e 25 K.P dënohet me 2 muaj burgim. Deklarohet fajtor për plagosje të lehtë me dashje në bashkëpunim dhe në bazë të nenit 89,25 K.P dënohet me 1 muaj burgim. Në bazë të nenit 55 të K.P dhe neni 406 K.PR.P dënohet me 5 muaj burg.

Gjykata e apelit me vendim nr.21 datë 30.03.1999 ka vendosur prishjen e vendimit nr.7 datë 01.02.1999 të gjykatës së rrethit gjyqësor shkodër e kthimin e cështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues. (Rehabilituar ne bazë të nenit 69 tek K.Penal)

Në bazë të vendimit nr.115 datë 29.04.2002 të gjykatës së rrethit gjyqësor Shkodër është deklaruar fajtor për veprat penale të heqje të paligjshme të lirisë parashikuar fajtor për veprat penale të heqje të paligjshme të lirisë se parashikuar nga neni 112/2 te K.P, për dhunim të baneses parashikuar nga neni 110/1 të K.P për armëmbajtje pa leje, parashikuar nga neni 89 të K.P , për plagosje të lehte me dashje parashikuar nga neni 89 të K.P. Në aplikimin të nenit 55 të K.P dhe 406 të K.PR.P është denuar me 6 muaj burg.

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstaton se për personat e shënuar në listën shumemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015. KQZ gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.



#### **Nr . 575 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit**

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumemërore për Këshillat Bashkiak , të Partisë Aleanca Demokristiane në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

**Bashkia Këlcyrë, nr. 3 z.Elidon Beqiri** në bazë të vendimit nr 33 date 30.07.2012 te Gjykatës Përmet është venosur,deklarimi fajtor per veprën penale te "Falsifikim i dokumentave dhe rezultateve të zgjedhjeve " "Kryer ne bashkëpunim" dhe dënohet me 8 muaj burgim. Në zbatim të nenit 59 të Kodit penal urdhërohet pezullimi I ekzekutimit të dënimit me burgim dhe me vënien e e tij në provë për një periudhe kohe prej 3 vjetësh. Gjykata e apelit Gjirokastër me vendim numër 166 I datës 15.11.2012 ka vendosur: Lënien ne fuqi të vendimit.

Referuar gërmes "b", të pikës 1 të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave të cilët kanë kryer vepra penale në fushën e zgjedhjeve, të parashikuar në Kreun X "Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve", të Kodit Penal;

Ligji nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", në nenin 4 të tij parashikon dhe periudhën gjatë të cilës zbatohen dispozitat e këtij ligji për ndalimin, kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit, në varësi të llojit të veprës penale të deklaruar/ dënuar.

Sipas nenit 4 të ligjit të sipërcituar

.....

Për personat që parashikohen nga shkronja "b", e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit për personat që parashikohen në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të mandatit zgjat 20 vjet nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Për sa më sipër duke qene se kushtet për ndalim janë verifikuar para procesit të pranimit të kandidaturës, referuar nenit 10 pika 1, germa "c" të ligjit nr. 138/2015, KQZ duhet të refuzoj kandidaturën e z.Elidon Beqiri.

Referuar nenit 33, germa "f" të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato bashki të cilat administrohen nga një KZAZ.

Referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe pikës 5/1, 6 të nenit 9 të udhëzimit nr.2, datë 29.01.2013 "Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve", KZAZ duhet vazhdojnë procedurat për regjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e Bashkisë, Pukë, Libohovë, Krujë, Këlcyrë, Kurbin, Malësi e Madhe, Mat, Prrenjas, Mirditë, Klos, Përmet, Gjirokastër, Tropojë, Dibër të Partisë Aleanca Demokristiane për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019. KZAZ duhet vazhdojnë procedurat për regjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e Bashkisë Këlcyrë duke zevendësuar nr. 3 z.Elidon Beqiri.



**Nr . 575 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit**

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak , të Partisë Aleanca Demokristiane në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

## PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa "a", e ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 5, pika 4, germa "f", të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

## VENDOSI:

1. Të refuzojë kandidaturën e z.Elidon Beqiri me nr. 3 Rendor për këshillin e bashkisë Këlcyrë, qarku Gjirokastër, Partia Aleanca Demokristiane.
2. Njoftimin e Partisë Aleanca Demokristiane të zëvendësojë kandidaturën brenda afatit të parashikuar për dorëzimin e kandidatëve.
3. Njoftimin e KZAZ-së përkatëse për vazhdimin e procedurave për rregjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e Bashkisë Pukë, Libohovë, Krujë, Kurbin, Malësi e Madhe, Mat, Prrenjas, Mirditë, Klos, Përmet, Gjirokastër, Tropojë, Dibër, Partia Aleanca Demokristiane për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
4. Njoftimin e KZAZ nr. 06 të vazhdojnë procedurat për rregjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e Bashkisë Këlcyrë, duke zëvendësuar nr. 3 z.Elidon Beqiri.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI</b>	<b>Anëtare</b>



### **Nr . 575 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit**

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak , të Partisë Aleanca Demokristiane në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.